



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.04.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARES SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI –KKSB-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të KKSB-së

Me këtë Vendim, **zëvendësohet** anëtarja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi **Gjyste Dabaj**, ish zyrtare për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore në Komunën e Lipjanit, në numrin rendor 13 të nenit 1 të Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.020-6049 të datës 31.01.2022, për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi –KKSB, për arsye të pensionimit dhe në vend të saj **caktohet Hasan Luma**, Zyrtar për barazi gjinore në Komunën e Lipjanit .

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSB-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-6049 i datës 31.01.2022.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-22355

Lipjan, më 28.04.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

